



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **KOMENTET E KRYETARIT TË PREZENCËS PËR MEDIAT GJATË NJË VIZITE NË BERAT**

*12 prill 2013*

**Ambasadori Wollfarth:** “Po shoh një proces të mirë. Gjatë vizitës në Berat, po përqendrohemi në përgatitjet që po bëhen këtu dhe ajo që kam dëgjuar e kam parë deri më tani është shumë pozitive. KZAZ-të janë konstituuar dhe po bëhet përzgjedhja e qendrave të votimit dhe vendeve të tjera. Nuk u vura në dijeni të ndonjë mosmarrëveshjeje. Është punuar edhe për listat e zgjedhësve, të cilat janë shumë më të sakta se në të kaluarën. Pra, shoh që po bëhet një punë shumë e mirë.

Do të doja të ftoja qytetarët të jepnin kontributin e tyre dhe, ajo që është më e rëndësishmja, të votojnë në ditën e zgjedhjeve. Duket sikur dita e zgjedhjeve është ende larg, më 23 qershor, por koha fluturon. Votimi është esenca e demokracisë. E shoh procesin vërtet në rrugë të mirë.

Duhet të ketë dialog të hapur në të dyja drejtimet. Politikanët dhe partitë duhet të prezantojnë programin që kanë në mendje, si dhe të shpjegojnë se si mendojnë ta vënë në jetë, gjë që përfshin financimin; si dhe qytetarët – për çfarë kanë nevojë, çfarë presin – dhe pastaj të gjenden zgjidhje realiste. Më e rëndësishmja është që kjo të bëhet me anë të një dialogu konstruktiv, paqësor dhe vërtet të qytetëruar, me tone të qeta.

Zhvillimi i Shqipërisë po ecën përpara dhe ka ecur përpara gjatë viteve të shkuara. Përpjekje shumë të mëdha janë bërë, në mënyrë të suksesshme. Të gjitha paratë që nevojiten për të financuar këto projekte duhet të fitohen, prandaj ekonomia dhe arsimit janë shumë të rëndësishëm. Shpesh, gjëra të tilla kërkojnë kohë dhe kontribut nga zyrtarët, por edhe nga qytetarët. Ky është një proces ku njerëzit duhet të jenë konstruktivë, por të jenë edhe disi të duruar dhe realistë shpresoj.

*[lidhur me çështjen e anëtarit të KQZ-së]* Ajo që ka ndodhur deri më tani është që komisioni i ligjeve ka marrë një vendim për të propozuar tërheqjen e njërit prej anëtarëve. Pra, nuk është një vendim i vlefshëm për anëtarët. Ai anëtar, sipas shumicës së interpretimeve, mund të vijojë të marrë pjesë në mbledhjet e KQZ-së, tani për tani. Jam në dijeni që po bëhen sqarime të bazës ligjore mbi të cilën mund dhe do të merret çdo vendim i mëtejshëm, pra po kalon më shumë kohë dhe kjo temë mund të rimerret të hënën nga Kuvendi. Duhet të ndjekim zhvillimet. Sigurisht, do të ishte shumë e rëndësishme që partitë politike ta shfrytëzonin në maksimum dialogun lidhur me këtë çështje, por pa harruar që, në fund të fundit, puna e KQZ-së është apolitike, është një punë teknike në shërbim të qytetarëve – nuk është punë partizane”.

**Fund**